

1-Mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2024

Totali i buxhetit për vitin 2024 ka qënë i planifikuar në vlerën 28,797,000.0 lekë dhe është realizuar në fakt 20,727,880.0 lekë. Më poshtë jepet buxheti i miratuar për këtë periudhë, sipas realizimit të zërave përkatës dhe konkretisht:

- Në zërin paga llogaria 600 fondi i miratuar në fillim të vitit ishte (18,783,000) lekë kemi një rishikim të buxhetit (shtesë fondi) në muajin korrik 2024 në shumën (453,000) lekë , kjo si pasojë e zbatimit të VKM nr.325 datë 31.05.2023, dhe në fund të vitit plani ka qënë **(19,236,000) lekë**. Realizimi i buxhetit për këtë zë shpenzimi është **14,066,059.0 lekë**, me një mosrealizim prej **(- 5,169,941) lekë**. Ky mosrealizim ka ardhur pasi nuk janë plotësuar vendet vakante që AAPSK ka sipas organikës së miratuar.
- Në zërin sigurime shoqërore llogaria 601 fondi i miratuar në fillim të vitit ishte (3,091,000) lekë, kemi një rishikim të buxhetit (shtesë fondi) në muajin korrik 2024 në shumën (76,000) lekë, kjo si pasojë e zbatimit të VKM nr.325 datë 31.05.2023 dhe në fund të vitit plani ka qënë **3,167,000.0 lekë**. Realizimi i buxhetit për këtë zë shpenzimi është **2,119,292.0 lekë**, me një mosrealizim prej **(-1, 047,708) lekë**. Ky mosrealizim ka ardhur pasi nuk janë plotësuar vendet vakante që AAPSK sipas organikës së miratuar.
- Në zërin shpenzime operative llogaria 602 nuk kemi ndryshime nga fondi i miratuar në fillim të vitit. Plani për periudhën e monitorimit është (**6,100,000) lekë** dhe realizimi është **(4,283,359) lekë**, kemi një mosrealizim në shumën (- 1,816,641) lekë.
- Në zërin fondë i vecantë në fillim të vitit nuk kishim fond të miratuar .Me rishikimin e buxhetit fondë i vecantë u shtua me **295,000 lekë** dhe u realizua në fund të vitit **261,170 leke**. Kemi një mosrealizim në shumën 33,830 leke.

2-Prokurimet për vitin 2024.

Mbi bazën e limiteve të fondeve të akorduara AAPSK-së për vitin 2024, është hartuar regjistri parashikimit të prokurimeve, i cili është publikuar elektronikisht në sistemin e APP.

Për vitin 2024 është hartuar regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike ku janë planifikuar 25 (njëzetë e pesë) procedura, konkretisht 14 blerje me procedure blerje me vlerë të vogël, 9 blerje me vlerë të vogël nën 100,000 lekë, 2 procedura prokurimi e hapur e thjeshtuar marrëveshje kuadër për tu realizuar nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Parashikimi për tu realizuar me fondin limit 16,744,849.46 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dyzetë e katër mijë e tetëqind e dyzetë e nëntë pikë dyzetë e gjashtë) lekë pa tvsh, konkretisht 4,370,000.00 (katër milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa tvsh nga buxheti i shtetit dhe 12,374,849.46 (dymbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzetë e nëntë pikë dyzetë e gjashtë) lekë pa tvsh nga të ardhurat e agjencisë.

Mbi bazën e këtyre parashikimeve janë realizuar gjithësej 14 (katërmbëdhjetë) procedura prokurimi nga ana e AAPSK-së me fond të realizuar 5,635,867.46 (pesë milionë e gjashtëqind

e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë dyzetë e gjashtë) lekë pa tvsh dhe 2 (dy) procedura prokurimi nga OBP, konkretisht:

1. "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel" me vlerë 2,717,640.0 lekë me tvsh.
2. "Shërbime topografike për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara për AAPSK" me vlerë 2,374,560.0 lekë me tvsh.